

VENDIM
Nr. 423, datë 26.6.2019

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 5.3.2019, PËR ÇËSHTJEN “RINALDO MYRTAJ DHE TË TJERËT KUNDËR SHQIPËRISË” (PËR KËRKESËN NR. 62907/16)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 5.3.2019, për çështjen “Rinaldo Myrtaj dhe të tjerët kundër Shqipërisë”, në shumën 39 000 (tridhjetë e nëntë mijë) euro për kërkuesin Rinaldo Myrtaj; 39 000 (tridhjetë e nëntë mijë) euro për kërkuesen Mamude Myrtaj; 15 600 (pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) euro për kërkuesin Ilmi Deda; dhe 10 000 (dhjetë mijë) euro për kërkuesen Alma Rredhi.

2. Vlera e përcaktuar si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, të konvertohet në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku depozitohen shumat, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të kërkuesve Rinaldo Myrtaj, Mamude Myrtaj, Ilmi Deda dhe Alma Rredhi, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet sipas vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 5.3.2019, për çështjen “Rinaldo Myrtaj dhe të tjerët kundër Shqipërisë”, kërkesa nr. 62907/16.

4. Pagimi i shumave të depozituara, sipas pikës 3, të këtij vendimi, në favor të kërkuesve Rinaldo Myrtaj, Mamude Myrtaj, Ilmi Deda dhe Alma Rredhi të bëhet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pas paraqitjes së dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit.

5. Mbi shumën e mësipërme, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, duke filluar nga data 28.6.2019 deri në datën e ekzekutimit të këtij vendimi, të paguhen interesa të thjeshta të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

6. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

7. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe